

STATUT I SHOQERISE
“ARMANDO TOUR OPERATOR” shpk.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 04 Mars 2022 (dy mijë e njezet e dy), personi i mëposhtem:

Armand Prenga, atësia Lek, amësia Marte, shtetas Shqiptar, lindur në FushëArrëz, Pukë dhe banues në LEZHË, me adresë Dakajt 03160035; Nd. 7; H. 1; Shënkoll; Shënkoll; 4511; Lezhë, lindur më 25/05/1990, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 037096317 dhe nr. personal J00525054J ,

ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miraton kete Statut si vijon:

KAPITULLI I
THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA

Neni 1
Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte “**ARMANDO TOUR OPERATOR**” shpk. Shoqeria “**ARMANDO TOUR OPERATOR**” shpk. eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” (me pas referuar si “Ligji Tregtar”) ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (shpk.). Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Biznesit (me pas referuar si “QKB”) ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji. Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj. Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 2
Selia

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e meposhtme: **Rruga “Pjeter Bogdani” Pallati nr. 13, Kati I-re, Hyrja 1, Njesia Bashkiake nr. 5, perballe Kopshtit nr. 31, Tirane, Shqiperi.** Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

- *Ndermjetës, operator udhetimesh dhe/ose agjensi udhetimesh,*
- *Agjensi turistike me profil te gjere dhe pa kufizime;*
- *Organizim udhetimesh individuale ose ne grupe per shtetas te huaj brenda dhe jashte vendit; Promovimi i turizmit ne Shqiperi dhe jashte saj; Shitje biletash, dhe jo vetem po edhe organizime turesh turistike brenda dhe jashte vendit; Organizmi transporti turistik tokesor, me guide shoqeruese dhe jo vetem, transport detar, ajror, agroturizem, trajnime, kurse te ndryshme dhe kualifikime ne fushen e turizmit. Organizimi i eventeve ne fushen e*



turizmit dhe perthithjes se turisteve te ndryshem; Organizimi i seminareve trajnuese dhe informuese per guida dhe/ose operatore te ndryshem turistike te huaj apo shqiptare; si dhe çdo aktivitet tjeter qe lidhet me kete objekt, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

- *ndërtim, blerje, qeradhenie, përdorimi dhe / ose menaxhimi i hoteleve,*
- *qendrat turistike, kampingjet, vilat turistike, restaurantet, qendra sportive dhe rekreative, qendrat e konferences;*
- *aktiviteti i asistencës teknike dhe tregtare në sektorin turistik;*
- *aktivitetet transporti për turizmin, rekreative, per kongreset dhe qe mund te kryhen me cfaredolloj mjeti;*
- *blerja ose qiradhenie e zyrave dhe / ose apartamenteve për ushtrimin e aktivitetit te saj;*
- *menaxhimi i zyrave të udhetimit dhe turizmi për palët e treta, shitja e biletave te avionit, trageetit, trenit dhe te cdo mjeti tjeter te transportit detar/tokesore/ajror;*
- *organizimi dhe zbatimi i eskursioneve individuale dhe ne grup dhe vizitat me guide neper qytete;*
- *lerja ose marrja me qira e mjeteve ajrore per kryerjen e udhetimeve turistike;*
- *marrja/rekrutimi i shërbimeve ajrore për realizimin e udhetimeve turistike dhe te linjes;*
- *projektimi, zbatimi, pershtatja, menaxhimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës dhe shërbimeve për turizmin;*
- *reklama, me cfaredo instrumenti dhe forme, por qe kane lidhje me turizmin;*
- *Për realizimin e objektit te veprimtarisë se saj, Shoqëria do te pajiset me të gjithë lejet, licencat dhe autorizimet e kërkuara sipas ligjit.*
- *Shoqëria mund te hyje ne tregje dhe operacione te zakonshme tregtare te lidhura me apo ne funksion te objektit kryesor te veprimtarisë. Ajo ka te drejte te zotërojë dhe administroje pasuri te luajtshme e te paluajtshme dhe pjesëmarrje e interesa ne shoqëri te tjera tregtare, vendase apo te huaja.*

Neni 4 Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pakufizuar. Shoqeria mund te prishet ne cdo kohe me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

KAPITULLI II KAPITALI – KUOTAT

Neni 5 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 ALL (njëqind mije Leke). Kapitali themeltar perbehet nga 1 (një) kuote qe paguhet e zotërohet teresisht nga ortaku themelues si vijon: Ortaku **Armand Prenga** zoteron 1 (nje) kuote me vlere nominale 100.000 leke, qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Ortaket jane pergjegjies kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

Neni 6 Kuotat Te drejtat dhe detyrimet e lidhura



Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij. Titulli i pronësisë mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve i cili do te mbahet ne selinë e Shoqërisë nen përgjegjësinë e Administratoreve (ne vijim “Regjistri i Ortakeve”). Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes qe zoterohet nga cdo Ortak; (iii) daten e fitimit te pronësisë se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

Neni 7 Kalimi i Kuotave

Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

Neni 8 Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete. Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

Neni 9 Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISE

Neni 10 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;

- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. ceshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktojte qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projektvendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katermbedhjete) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per cdo ceshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ceshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ceshtje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakëve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut te interesuar / perkates.

Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

Organi Administrues / Administratoret

Organi Administrues perbehet nga 1 (nje) Administrator qe emerohet e shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Kohezgjatja e mandatit te Administratorit eshte 5 (pese) vjet, me te drejte ri-emerimi.

Ortaku i vetem z. Armand Prenga, atësia Lek, amësia Marte, shtetas Shqiptar, lindur në FushëArrëz, Pukë dhe banues në LEZHË, me adresë Dakajt 03160035; Nd. 7; H. 1; Shënkoll; Shënkoll; 4511; Lezhë, lindur më 25/05/1990, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 037096317 dhe nr. personal J00525054J, caktohet Administrator i parë i shoqërisë me mandat 5 vjeçar:

Administratori perfaqeson Shoqerine sipas parashikimeve te Statutit.

Administratori do te:

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
 - (ii) perfaqesoje Shoqerine;
 - (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
 - (iv) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
 - (v) krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
 - (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
 - (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
 - (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
 - (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.
- Administratori mund te autorizojë persona te tjere per te vepruar ne emri dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorine e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje. Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

Neni 12

Kontrolli i Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 14

Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 15



Dividendet

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

KAPITULLI V PRISHJA - LIKUIDIMI

Neni 16 Prishja e Shoqerise

Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKB; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

Neni 17 Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

Neni 18 Dispozita Perfundimtare

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar.

Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangien e cdo paqartesis, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose cdo funksionari tjetër nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

Ky Statut nenshkruset rregullisht ne 3 (tre) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe i cili autorizon Znj. Irga Sadiku dhe/ose Znj. Malvina Piro, qe te ndjekin te gjitha procedurat perkatese per depozitimimin e ketij statuti ne QKB dhe regjistrimin e shoqerise ne regjistrin tregtar Shqiptar.

**ORTAKU THEMELUES
Armand Prenga**

ARMAND PRENGA

